



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 928 Prot.

Tiranë, më 27.06 2019

VENDIM Nr. 171 datë 25.06.2019

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"* Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.8, datë 25.06.2019, pasi shqyrtoi *projektin kërkimor shkencor të ri "Tempulli i Shtyllasit-Arkitectura dhe rivlerësime arkeologjike" 2019*, drejtuar nga Prof.Dr. Bashkim Lahi dhe Prof.Dr. Stephan G. Schmid Winkelmann (Universiteti Humboldt, Berlin). miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë.

VENDOSI:

1. Të miratojë *projektin kërkimor shkencor të ri "Tempulli i Shtyllasit-Arkitectura dhe rivlerësime arkeologjike" 2019*, drejtuar nga Prof.Dr. Bashkim Lahi dhe Prof.Dr. Stephan G. Schmid Winkelmann (Universiteti Humboldt, Berlin), miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
 - Survey i cili përfshin grumbullimin e gjetjeve sipërfaqësore dhe rilevimin e kodrës.
 - Dokumentimi i kolonës dhe strukturave ndërtimore.
2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë ajo e nevojshme për kryerjen e tyre, brenda vitit 2019.
3. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
4. Të depozitohet pranë ASHA dhe DRKK lista e gjetjeve me qëllim grumbullimin dhe ekspozimin e tyre në Muze.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
ELVA MARGARITI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO



Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@usha.gov.al

Website: asha.gov.al